



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN  
E MJEDISIT TË KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA  
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL  
PROTECTION AGENCY

---

**Raport nga pjesëmarrja në takimit e 29 plenar  
i Rrjetit EPA**

**Hyrje-**Nga data 24-27 shtatore 2017 në Stokholm te Suedise është mbajtur takimi i 29-te plenar i Rrjetit EPA (Rrjeti i Kryeshefave dhe Drejtorëve të 39 Agjencive të Mjedisit të vendeve te Evropës dhe Agjencisë Evropiane te Mjedisit).

**Organizatori-** Ky takim vjetor është organizuar nga Rrjeti EPA me mbështetjen e Agjencinë së Mjedisit të Evropës, me nikoqir SEPA (Agjencia Suedeze e Mjedisit) Suedi.

**Qëllimi i takimit** takimi i rrjetit te drejtoreve per të diskutuar aktivitetet, progresin dhe ngjarjet e organizuara në mes të dy takimeve. Është diskutuar për prioritetet e tanishme dhe te ardhshme te politikave mjedisore te Komisionit European. Theks i vecant i shte dhene Qyteteve te Qendrueshme dhe Mjedisore dhe implementimi i strategjise SDG11.

Eshte diskutuar edhe ne lidhje me natyren dhe afrimin e saj me njeriun dhe qeshtje tjera sipas GI (grupeve te interesit) te themeluara ne punimet e meprshme.

Referues i pare ka qene DG Environment i Komisionit European z. Gilles Gantelet. DG foli per politikat e tanishme dhe te ardhshme te KE dhe zhvillimi i politikave mjedisore ne vazhdimesi.

Takimin e ka pershendetur me nje fjale rasti Ministresha e Suedise per Mjedis zonja Karolina Skog dhe zv. Kryetarja e Stokholmit per mjedis zonja Katarina Luhr.

**Sesioni i 1:** ishte lidhur me Stokholmin si model i nje qyteti per qendrueshmeri.

Suedia ka marre per siper implementimin e SDG perfshire SDG11 te qytetit te qendrueshem.

Prioritete te tjera te Sesionit te pare ishin Konservimi i Natyres, berja e natyres te arrijeshme per qytetaret, etj.

Adresimi i perfshirjes se elementeve per strategjine e qendrueshme.

Qendrueshmeria financiare duke percjellur aspektet klimatike. Lidhshmeria mes qytetareve eshte esenciale. Potenciali i rrjetit EPA per te pergatitur projekte shkencore per qytetaret dhe perfshirja e tyre ne projekte. EPA te sielle perpara fonde strukturale per projekte per autoritete menagjuese dhe DG REGIO.

DG Environment eshte duke organizuar javen e gjelber me fokus SDG11 ne maj 2018- te hapur per ndryshime nen pergatitje te EPA-s.

**Sesioni i 2:** Dialogu stimulues, fuqizimi i njohurive baze per qytetaret perfshi imazhet satelitore, akte te keshillimeve te qytetareve, te mesojme nga qytetet, qellimet e reja qeverisese, shkembimi i pervojave ne nivel evropian etj.

**Sesioni 3.** Trojka mori mandatin per rekrutimin e seketares se re. Kerkoi nga anetaret te propozojne persona qe mund te konkurojne.

Grupi i Interesit per ekonomine e gjelber dhe qarkore u fokusua ne perpunim te projekteve, shperndarjen e pervojave me te mira etj. GI per OMGJ nen udheheqje te Zvicrres presantoi te arriturat me te reja te Organizmave te Modifikuar Gjenetiksht. GI per plastike i udhehequr nga gjermania dhe Austria presantoi punen e arritur deri me tani.

Rrjeti i EPA u pajtua per publikimet ne te aedhmen. Po ergatitet edhe Publikimi i Raportit te gjendjes se Mjedsit ne Europe.

**Sesioni i 4:** Direktiva INSPIRE eshte ne domenin specifik te rendesishem ne ilustrimin e kornizes interoperacionale. Kerkesat e njohurive per menaxhimin e te dhenave dhe kooperimi mes EPAs.

Pronesia e te dhenave eshte qeshtje komplekse sepse ato mund te shperndahen edhe nga kompani private ne te ardhmen.

U dha idea qe web i EEA te jete e publikuar edhe ne web-e te linqeve nacionale.

**Sesioni i 5:** u diskutua per takimin e 30 te rrjetit EPA i cili do te mbahet nga 12-14 prill 2018. U diskutua per temat e mundshme dhe per detyrat qe duhet te kryhen deri ateher.

Pervec ketyre temave te mbledhjes Plenare, nje dite para takimit u vizitua Parku Nacional Tyresta me 5000 ha. U vizitua qendra ose shtepia a parkut nacional dhe dolem ne terren per ti pare te mirat e parkut dhe metodat e ruajtjes. Suedia kishte 29 parqe kombetare si zona te mbrojtura ku nuk lejohet asnje aktivitet. 12% e Suedise ishte ne keto 29 parqe dhe e tere pronesia ne to ishte publike. Suedia kishte ne procedure edhe 4 parqe kombetare te cilat do ti shpallte deri ne vitin 2020.

Kurse pas takimit plenar vizituam lagjen e vecante te Stokholmit ku ishte duke u dekontaminuar dhe sanimi i pjeses industriale dhe po ngritej nje pjese e qytetit miqesore me mjedisin si program shembull per boten, per qytete te qendrueshme mjedisore per te ardhmen. Ishte nje projekt qe ka angazhuar gjithe arkitektet e Evropes dhe ishin ndertuar ndertesa me energji alternative dhe eficience te energjise dhe kulme te mbuluara me gjelberime qe ishin me te vertete fascinante.

Përveç tjerash kisha takim gjate drekave dhe darkes se organizuar enkas per ne, me drejtorin e Agjencise Evropiane te Mjedisit z. Hans Bruinckx, Presidenten e UBA Gjermani, drejtorin e ISPRA Itali, perfaqesuesit zvicerian dhe ata spnjoll. Takim te vecant dhe bashkebisedim lidhur me bashkepunime te mundshme kisha edhe me Drejtorin e Agjencise Hungareze dhe Drejtoreshen e Agjencise Bullgare.

**Pjesëmarrësit e takimit-** Në takim kanë marrë pjesë përfaqësues nga shumica e Agjencive të Mjedisit të Evropës dhe institucioneve paralele, përfaqësues nga Agjencia e Mjedisit të Evropës, përfaqësues nga Drejtorati për Mjedis të Komisionit Evropian dhe institucione, organizata dhe rrjete tjera mjedisore te Evropës.

**Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit te Kosovës** është anëtare e Rrjetit EPA, me te drejta te plota që nga viti 2011, dhe është pjesëmarrëse e rregullt dhe aktive në të gjitha forumet e këtij rrjeti (kjo rrjedhe edhe si obligim ligjore nga Ligji i Mjedisit i Republikës se Kosovës neni 60, paragrafi 1.11, 1.12, 1.13).



Konferenca Plenare



Foto e Perbashket



*Vizita pjeses se qytetit me zhvillim te qendrueshem*



*Vizita Parkut Tyresta*

## **Përvojat e fituara**

Gjatë pjesëmarrjes në këtë konferencë pjesëmarrësit kanë fituar përvoja nga:

- Punën e Agjencive të Mjedisit të Evropës për projekte dhe çështje të caktuara mjedisore.
- Politikat dhe strategjitë në nivel evropian por edhe në nivel të shteteve evropiane për çështje të ndryshme mjedisore,
- Projektet e ndryshme mjedisore dhe mundësitë e bashkëpunimit dhe përfitimit të fondeve.
- Nevojat për ristrukturimin e rrjeteve dhe Agjencive për tu përshtatur me politikat e reja dhe kërkesat mjedisore.
- Takimi me disa nga drejtoret e disa agjencive të shteteve mike dhe diskutimi i mundësive të bashkëpunimit. P.sh. biseda me presidenten e UBA të Gjermanisë znj. Krautzberger për projektin e përbashkët të biodiversitetit nga ORF GIZ për Ballkanin, drejtorin e Agjencisë Italiane për bashkëpunim në fushën e ujërave nëntokësore,

Drejtorin e UBA Austri për fushën e zonave të mbrojtura të natyrës dhe monitorimin e ajrit etj.

- Me e rëndësishmja, të jesh hartues, vendimmarrës dhe dëshmitarë i politikave mjedisore evropiane dhe globale

## **Rekomandimet**

- Të vazhdohet bashkëpunimi me Rrjetin EPA, me Agjencinë e Mjedisit të Evropës dhe me Agjencinë tjera të shteteve të Evropës;
- Të shkëmbehen përvoja dhe praktika të mira për çështje të caktuara mjedisore me këto agjenci dhe rrjete;
- Të vazhdojë angazhimi në kuadër të Grupit të Interesit për Ballkanin Perëndimorë për projektet e filluara dhe projektet e reja;
- Të shfrytëzohen mundësitë që ofron rrjeti për komunikim me donator dhe përfitim të projekteve.